

# NACIONAL

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Poetja Elida Buçpapaj polemizon me shkrimtaren Elvira Donez

## Në mbrojtje të Berluskonit

"Donez e gjykon pa të drejtë kryeministrin e Italisë për batutën e tij"

faqe 9



Si e ndihmoi Shqipëria lëvizjen guerile greke.

## Pasojat tek çamët edhe Çameria

Dossier nga Dr. Ilir Kelmendi faqe 19



## EDITORIAL

Silvana Braçe rrefen jetën mes Italisë dhe Shqipërisë si dhe kujtimet nga TVSH

### Pavarësia e Kosovës

Nga Skënder Buçpapaj

Është Epika e Zgripeve të Fatit. Dhe ky do të ishte titulli i saj, nëse nuk do të isha rob i dyvargëshit aq mahnitës në mbyllje të epikës.

Është Epika e Filozofisë së Zgripeve të Fatit. Është një epikat që e mbaj më shumë për zemër në gjithë letërsinë shqipe. I mbush plot 100 vjet në pranverë. E kremton ditëlindjen bashkë me Kosovën në djyvetorin e pavarësisë, dasmore e kësaj kremteje, e ftuar e vetvetes.

P ikëtakohen përgjatë shekullit të jetës së saj tre burra dhe e ndërthurin kështu fatin e saj të deritanishëm. Hilë Mosi e shkruante më 19 10, me titullin "Kosova në luftë" dhe e përfshinte në librin

Vijon në faqen 23

### Si e rrëzuar shtatoren e diktatorit

Nga Saimir Maloku

Kanë kaluar 19 vjet kur populli demokrat i Tiranës më 20 shkurt 1991 rrëzoi monumentin e diktatorit komunist më të egër në Europë. Rrëzimi i këtij monumenti për mua si një protagonist i asaj dite ishte momenti më kulmor i shekullit të kaluar për popullin shqiptar. Kjo ditë shënoi ndarjen e dy sistemeve në vendin tonë, përmbysjen e simboleve të diktaturës komuniste dhe vendosjen e demokracisë edhe të fesë në Shqipëri.

Qyteti "Studenti" nga 8 dhjetori 1990 deri në shkurt 1991, me plot të drejte mund të quhet si vendi dhe zemra e protestave dhe mitingjeve të shumta ku studentet të kryesuar nga Azem Hajdari dhe të perkrahur dhe mbeshetur nga populli i Tiranës parashtronin kërkesat e tyre

Vijon në faqen 14

# Si më ndiqnin në burgun e Burrelit

Prezantuesja e famshme flet ekskluzivisht për "Nacional" faqe 8



2101 vargje poezie nga Bedri Myftari, poezi nga: Avni Mulaj, Nazim Hikmet, Friedrich Nietzsche, Jorge Borges, Dmitrij Aleksandrovic Prigov, Bertolt Brecht, Primo Levi, kritikë nga: Rexhep Polisi, Demir Gjergji, Selim Krasniqi, Martin Mato, Naim Kelmendi, Ivan Bonin.

## Në BRENDËSI

### Nobelista Nadine Gordimer

Studim nga Endrit Shtylla

faqe 15

### Letërsia e Petro Markos

Esse nga Dr. Agim Vinca

faqe 6

### Si SH.B.A shpëtoi Rusinë

Esse nga George Seldes

faqe 10

### Lumi Lotonë

Pemë nga Adem Istrefi

faqe 5

### Ambasadori Whithers dhe opera e Tiranës

Intervisë me maestron Zhani Ciko

faqe 3

### Proza e Richard Powers

Studim nga Gjekë Marinaj

faqe 18

### Trofetë ndërkombëtare të piktorit Agim Sulaj

Esse nga Laureta Petoshati

faqe 4

### Nata e trokitjeve në xhama

Nga Dhimitër Anagnosti, Artist i Popullit

faqe 4

### Botohet antologjia e poezisë shqipe në Londër

Nga Fatmir Tërziu

faqe 11

**ARMO** Albanian Refining & Marketing of Oil

PËR HERË TË PARË  
EURODIESEL  
I STANDARTEVE EUROPIANE

**PCALBANIA**  
Broker Sigurimesh

Aty ku siguria është Art




“Jehona e Kujtesë” si një pikë reference në letërsinë artistike

# HOMO-SAPIENS I RICHARD POWERS-IT

“Thjeshtë, Powers është një shembull i gjenit autentik dhe “Jehona e Kujtesës”, një vepër monumentale në shërbim të humanizmit bashkëkohor.”

Nga Gjekë Marinaj



Megjithatë ajka e burimeve të famës së fituar prej tij si shkrimtar, qëndron larg çdo egoizmi profesional. Në bërthamë, ajo është dhe mbetet thjeshtë një shpërblim i përpjekjeve të sinqerta për të përdorur analogji dhe shprehje sa artistike aq edhe shkencore në kërkimin e tij letrar për të gjetur të tjera domethënie në univers. Duke ftuar shpirtin dhe duke kultivuar intelektin që zotëron, ai vë në lëvizje të gjithë talentin dhe njohuritë që ka për të arritur diskursin më efikas në kohën dhe problemet që trajton në *Jehona e Kujtesës*. Asgjë nuk ka ardhur lehtë për Powers. Atij i janë dashur më se katër vjet për ta shkruar këtë libër, derisa radari kulturor i tij është kthyer veçanërisht nga shkenca.

Ashtu si për Viktor Hugo që fjala *Fatalitet* në muret e Katedrales së Parisit u bë shkak që shkroi Katedralen e Parisit, edhe për Richard Powers një rastësi u bë shkak për të shkruar këtë vepër. Krejt rastësisht ai gjendet pranë gjysmë milioni lejlekësh në fluturim që ecnin paralel me makinën e tij në një nga autostradat e shtetit Nebraska. I mahnitur nga bukuria dhe çudia njëherësh, Powers vendosi ta dedikojë vëmendjen dhe kohën e tij në dy drejtime, të reja për të, që çuan në realizimin e këtij romani. Nga origjina e kësaj rastësie buroi dhe nisma e tij të merrej me studimin e lejlekëve si edhe të një sëmundje të rrallë të trurit, e quajtur Sindroma e Kepgrasit. Bashkimi i njohurive të reja, si rezultat i këtyre studimeve në bashkëveprim me kulturën e përgjithshme të tij si profesor dhe si romancier, e shpjegon kompleksiteti i rrallë ideor i romanit në lidhje me rëndësinë e një momenti në kohë dhe e një individi në shoqëri. Në të njëjtën kohë, autori reflekton shqetësimin që ndanë me njeriun amerikan të kohës, kundrejt humbjes së rëndësisë së diferencimit njerëzor nga natyra e simboleve tradicionale e shoqërore, nga konsekuencat që ballafaqon dhe ambiguiteti i rrezikut që paraqet ky diferencim. Ky koncept analitik, që përbën një pjesë të mirë të drejtimit të romanit, e çon lexuesin edhe tek një linjë tjetër interpretimi. Është fjala për përkufizimin e rastësisë, si një ritëm eklipsues funksionimi në jetë, e cila ecën paralel me dyshimin e njeriut tek vetja, brenda kontekstit të situatës specifike që i krijohet. Për fat të mirë Dollani ka mundur ta përkthet me korrektësi këtë thellësi filozofike të sofistikuar. Vështirësitë duhet të kenë qenë edhe më të mëdha, kur mendojmë se të dyja, sasia e

domosdoshme e informacionit për të organizuar dhe përkufizuar secilën temë, si dhe saktësia linguistike e vënë në shërbim të strategjisë autoriale për t'i avancuar ato, janë tërësisht të fshehta në çdo paragraf, madje nga ana teknike edhe të ndryshueshme. Siç mund të merret me mend, njohja e anglishtes dhe e shqipës nuk të garanton kurrë një përkthim si ky që kemi në dorë. Ky përkthim është produkt i njohjes së padiskutueshme të parës dhe të dytës, por përveç tyre, ajo që e bën librin *Jehona e Kujtesës* të jehojë kaq natyrshëm në shqip, në kuptimin me elegant të fjalës, është njohuria e gjuhës së artit të përkthimit, pa të cilën përkthyesit do të ishin vetëm njerëz që flasin më shumë se një gjuhë, por jo përkthyes.

Natyrisht *Jehona e Kujtesës* nuk do të meritonte asgjë më pak. Aq më tepër kur drejtimi inteligjent i romanit nga Powers, pa u mundur fare për ta justifikuar vlerësimin që gëzon si një nga shkrimtarët më të sofistikuar dhe më me influencë nga të gjithë romancierët amerikanë të kohës, ka mundur ta bëjë veprën të depërtueshme pa u detyruar të bëjë kompromis me intelektin autorial. Prej letërsisë së tij tashmë nuk pritet vetëm argëtim por edhe mësim. Të mësohet duhet të studiohet. I ndërjegjshëm për këtë dhe për njohuritë që kërkonte harmonizimi i të dy temave kryesore të romanit, ekologjia dhe neuropsikologjia, Powers kërkoi ndihmë nga ekspertët e këtyre dy fushave, duke studiuar për katër vjet me seriozitetin me të madh, dhe duke ndjekur rregullisht seminarët e diskutimeve kërkuese në Institutin për Shkenca dhe Teknologjitë e Avancuara në Beckman. Dhe mundimi nuk i ka shkuar kot. Aktin e tij e kanë vlerësuar jo vetëm lexuesit, por edhe ekspertët e letërsisë si R. Baird Shuman. Ai mendon se shënjestra e romaneve të Powers “është që të edukojnë, ta tendosin mendjen. Autori zbrast edukimin e shkëlqyer të tij në çdo faqe, por në proces edhe ai është duke vazhduar edukimin e tij. Lexuesit që e shoqërojnë atë në shtegtimin që ka vendosur të marrë, u kërkohet t'i përveshen punës, aq fort sa ç'punon ai vetë. Nëse ata e ndjekin atë, kanë gjasa të mira që do të shpërblehen aq shumë sa ç'shpërblehet ai vetë nga zbulimet intelektuale e kënaqësitë e përgëzimit që ai vazhdimisht përjeton”.

Ndonëse aftësia për të njësuar detajet reale, mprehtësinë e observimeve, si dhe imagjinatën vizionare nga kapitulli në kapitull si një trajektore shtesë që buron nga talenti i tij, shumica e kritikëve do të binin dakord se këto forca artistike në prozën e Powers janë më tepër se gjithçka tjetër rezultat i një ekzekutimi mjeshteror. Ai mendon për çdo fjalë e për çdo rresht që shkruan se si do i shërbejnë strukturës së përgjithshme të romanit. Ja një ilustrim konkret nga gjerësia e konceptimit letrar që zotëron. Libri ndahet në pesë kapituj. Çdo kapitull mban si titull një nga vargjet e një letre që gjendet në trupin e personazhit kryesor, Markut, qysh në faqet e para të librit ku ai bën një aksident me makine dhe gjendet pa ndjenja: U në jam Kurrkushi / por Sonte në Rrugën Veriore / Zoti më drejtoi tek ty / që Ti të jetosh / dhe të sjellësh dikë tjetër. Këtë metodë proze e ka vënë re edhe kritika, e cila mendon se “misteret e përshkrimeve dhe dijes, të normalitetit, të mosfunksionimit, të realitetit dhe të ëndrrës-të gjitha janë jehona të mëdha-shtyse të misterit në lidhje me neg-



Në foto: Gjekë Marinaj

lizhencën e marrëdhënieve të njerëzve me pjesën tjetër të natyrës dhe të vetvetes” (Washington Post).

Thënë ndryshe, Powers ka krijuar skena dhe situata që janë dhe mbeten të gjalla në imagjinatën e lexuesit. Mjeshhtëria e vërtetë prej tregimtari është se personazhi i tij kryesor nuk paraqitet homo-fiktiv por homo-sapiens. Ai e ruan lexuesin për të mos rënë në turbinën e të rëndomtës artistike dhe qëndron gjithnjë në ndjekje të së jashtëzakonshmes. Ndaj *Jehona e Kujtesës* ka më gjasa të gjendet në duart e profesorëve të letërsisë nëpër universitetet se sa në duart e udhëtarëve të thjeshtë nëpër trena e autobusë. Sepse, siç cituam më lart, ky është një roman për ta tendosur mendjen, jo për ta vënë në gjumë atë. Ky është një nga romanet e rrallë që ka si shtyllë kurrizore një personazh si Mark Shluter. Ai nuk është i rrafshët apo një-dimencional, por i ndërtuar nga të gjitha pikëpamjet me mjeshtri, i besueshëm për ta tërheqë lexuesin në situata jetësore të paimagjinueshme. Ai ka tri përmasa të plota që funksionojnë në mënyrë krejt natyrale duke filluar me ato fiziologjike, sociologjike dhe psikologjike. Powers i jep atij një biografi fiktive jashtëzakonisht interesante, duke e krijuar si një personazh të pasur, që në rastin tonë është kompensuar nga pasuria e shqipes për atë bjerrje artistike që mund të kishte pësuar gjatë përkthimit. Çka do të thotë se i gjithë libri nuk ka humbur pothuajse asgjë gjatë këtij procesi.

Në mbyllje do shtoja se aftësia e Powers për ta parë në një hapësirë të gjerë aplikimin e mundësive autoriale në strukturën e romanit, është një cilësi sa letraro-artistike aq edhe akademiko-shkencore, që së bashku në këtë libër përfaqësojnë zgjedhjen më të mençur nga alternativat e shumta që ka pasë ai autor. Megjithëse, po t'i referohemi edhe një herë profesorit R. Baird Shuman, “letërsia e Powers është më pak e kapshme se romanet e John Steinbeck, Ernest Hemingway, Saul Bellow, madje edhe William Faulkner, Henry James, e Herman Melville; intelektit i tij qëndron përbri intelektit madje edhe të shkrimtarëve më të shquar të historisë së letërsisë së shteteve të bashkuara. Në mes të romancierëve bashkëkohor, ai mund të krahasohet direkt me Thomas Pynchon and Don DeLillo. Ai, sidoqoftë, ka kohë që i ka tejkualuar arritjet e tyre nëpërmes kombinimeve të rralla të mprehtësisë intelektuale, përsosmërisë, dhe stilit të tij arkitektonik”.

Thjeshtë, Powers është një shembull i gjenit autentik dhe *Jehona e Kujtesës*, një vepër monumentale në shërbim të humanizmit bashkëkohor.

Si mjeshtrë i gjuhës metaforike dhe simbolizmit të unifikuar letrar, i përgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për rolin që ka, Powers ka zgjuar interes të lexuesit edhe për adresimin e çështjeve të shkencës mjekësore dhe atyre sociale, si probleme të njësuar, një trup i vetëm, pro dhe kundër njeriut. Idetë e tij janë kthyer në shtytës të pazëshëm për vënie në lëvizje të elitës së secilës fushë që të demonstrojë qëllimet e tyre në këtë botë, të cilat nga vetë implementimi zgjojnë një debat kulturor që shpalos një evolucion unik të natyrës njerëzore në të mirë të ekuilibrit ndjenjëmendje në letërsi. Dhe për aktivitetin e tij, ai është shpërblyer me mirënjohje pothuajse më shumë se kushdo tjetër në letërsinë e sotme amerikane. Sidomos kur kemi parasysh se *Jehona e Kujtesës* është libri i nëntë i Richard Powers. Ai e ka filluar karrierën e tij në vitin 1985 kur pati botuar romanin e parë “Tre fermerë në rrugën e tyre për tek një vallëzim”. Që në fillimet e punës, nderimet dhe çmimet letrare nuk e kanë ndaluar hovin drejt tij: Powers ka qenë kandidat tre herë për “Çmimin e Rrethit të Kritikëve Kombëtar të Librit” (National Book Critic’s Circle Award). Ai ka fituar të dyja Çmimet e Gjenit (Genius) që jepen në Amerikë: MacArthur Fellowship dhe Guggenheim, si edhe “Çmimin Letrar Lannan” (Lannan Literary Award). Është zgjedhur, gjithashtu, në Akademinë e Arteve dhe të Shkencës Amerikane (American Academy of Arts and Sciences). Ai ka fituar Çmimin “Corrington” për përsosmëri në letërsi, si dhe Çmimin letrar Dos Passos. Libri *Jehona e Kujtesës*, përveç që mori çmimin Kombëtar, ishte edhe finalist për Çmimin Pulitzer.

edrales së Parisit u bë shkak që shkroi Katedralen e Parisit, edhe për Richard Powers një rastësi u bë shkak për të shkruar këtë vepër. Krejt rastësisht ai gjendet pranë gjysmë milioni lejlekësh në fluturim që ecnin paralel me makinën e tij në një nga autostradat e shtetit Nebraska. I mahnitur nga bukuria dhe çudia njëherësh, Powers vendosi ta dedikojë vëmendjen dhe kohën e tij në dy drejtime, të reja për të, që çuan në realizimin e këtij romani. Nga origjina e kësaj rastësie buroi dhe nisma e tij të merrej me studimin e lejlekëve si edhe të një sëmundje të rrallë të trurit, e quajtur Sindroma e Kepgrasit. Bashkimi i njohurive të reja, si rezultat i këtyre studimeve në bashkëveprim me kulturën e përgjithshme të tij si profesor dhe si romancier, e shpjegon kompleksiteti i rrallë ideor i romanit në lidhje me rëndësinë e një momenti në kohë dhe e një individi në shoqëri. Në të njëjtën kohë, autori reflekton shqetësimin që ndanë me njeriun amerikan të kohës, kundrejt humbjes së rëndësisë së diferencimit njerëzor nga natyra e simboleve tradicionale e shoqërore, nga konsekuencat që ballafaqon dhe ambiguiteti i rrezikut që paraqet ky diferencim. Ky koncept analitik, që përbën një pjesë të mirë të drejtimit të romanit, e çon lexuesin edhe tek një linjë tjetër interpretimi. Është fjala për përkufizimin e rastësisë, si një ritëm eklipsues funksionimi në jetë, e cila ecën paralel me dyshimin e njeriut tek vetja, brenda kontekstit të situatës specifike që i krijohet. Për fat të mirë Dollani ka mundur ta përkthet me korrektësi këtë thellësi filozofike të sofistikuar. Vështirësitë duhet të kenë qenë edhe më të mëdha, kur mendojmë se të dyja, sasia e